



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 maj 2014
Nr. ref.: RK624/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI222/13

Parashtrues

Rrustem Veseli dhe Xhafer Zeqë Smajli

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të
Gjykatës Supreme, Rev. nr. 118/2012, të 10 qershorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga z. Rrustem Veseli dhe z. Xhafer Zeqë Smajli, nga Gjakova (në tekstin e mëtejshmë: parashtruesit), të përfaqësuar nga z. Prenk Pepaj, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 118/2012, të 10 qershorit 2013, i cili, sipas parashtruesve, u është dorëzuar atyre më 29 gusht 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 118/2012, të 10 qershorit 2013. Parashtruesit konsiderojnë se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tyre pronësore.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 10 dhjetor 2013, parashtruesit parashtruan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 13 janar 2013, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI222/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI222/13, caktoi Kolegin shqyrtyes, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 27 janar 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesit të dorëzojnë autorizimin.
8. Më 27 janar 2014, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për kërkesën.
9. Më 10 shkurt 2014, parashtruesit e dorëzuan autorizimin në Gjykatë.
10. Më 25 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtyes i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kérkesës.

Përbledhja e fakteve

11. D. H. është ish-bashkëshortja e parashtruesit Rrustem Veseli. Parashtruesi i kérkesës, Rrustem Veseli ia shiti pronën parashtruesit të dytë, Xhafer Smajli. Duke kérkuar anulimin e kontratës së shitjes D. H. paraqiti padi në gjykatën e rregullt.
12. Më 24 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë nxori Aktgjykin C. nr. 557/06, me të cilin konfirmoi se kontrata e shitjes së pronës, në mes të parashtruesve për gjysmën e pronës është nul dhe prandaj nuk ka efekt ligjor, për më tepër, vërtetohet se D. H. është pronare e gjysmës së pronës. Gjykata Komunale në Gjakovë konstatoi se “*Sipas dispozitës ligjore të nenit 307 par. 1*

të Ligjit mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare pasuria të cilën bashkëshortët e kanë fituar me punë gjatë bashkësisë martesore si dhe të hyrat nga ajo pasuri, janë pasuri e përbashkët, pra duhet të përmbushen kumulativisht dy prezumime ose kushte: 1) Puna e përbashkët dhe 2) ekzistimi i bashkësisë martesore. Kushte këto të cilat paditësja, ashtu sikundër edhe i padituri i parë i plotësojnë. Puna e paditëses mund të konsiderohet edhe si punë indirekte (si psh. puna rreth kujdesit të fëmijëve dhe pregaditjes së ushqimit për familjen), sepse për punën e kryer nuk merret kurrfarë shpërblimi, por kontributi qëndron në mundësimin e bashkëshortit tjetër me punë të drejtpërdrejtë të fitoj të drejta. Kështu puna e bashkëshortit por edhe ndihma e njëjtë, e njërit bashkëshort që i jep bashkëshortit tjetër, si kujdesi për fëmijë, udhëheqja e punëve shtëpiake, kujdesi dhe ruajtja e pasurisë së përbashkët neni 314 i Ligjit të lartcituar) janë kontribute të cilat në rastin konkret i dedikohen paditëses (dhe të cilat i kanë japur kohë dhe mundësi të paditurit të parë që të merret edhe me veprimtarinë e mbikëqyrjes së një ndërtese në Austri, ku ka realizuar edhe të ardhura) dhe për këtë arsyе rrjedhë edhe konkludimi se “pasuria e fituar në martesë me punën e bashkëshortëve është pasuri e përbashkët”. Andaj, Gjykata paditëses në rastin konkret ia aprovoj tërësisht kërkesë padinë e saj të precizuar”.

13. Më 5 mars 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin Ac. nr. 390/2011, e refuzoi ankesën e parashtruesve si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë.
14. Më 10 qershor 2013, Gjykata Supreme, me Vendimin Rev. nr. 118/2012, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesve për revizion. Gjykata Supreme konstatoi se gjykatat e shkallëve më të ulëta e kanë vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe e kanë zbatuar drejt ligjin material.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesit pretendojnë se “[...] AKTGJYKIMIET e Gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i Gjykatës Supreme të Kosovës, në Prishtinë janë marrë në kundërshtim me dispozitën e nenit 103. al. 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (atëherë të aplikueshëm në Kosovë)”.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve, duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përbashbur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Neni 113.7 i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme në mënyrë që kërkesa të konsiderohet e pranueshme:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Për më tepër, rregulli 36 (1) c) i Rregullores parashevë se:

“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: kërkesa është qartazi e bazuar”.

19. Bazuar në dokumentet e dorëzuara, Gjykata vëren se pretendimet e bëra nga parashtruesit në Gjykatë janë të bazuara në shkeljen e Ligjit për marrëdhëniet detyrimore dhe jo në Kushtetutë.
20. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të janë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
21. Në këtë mënyrë, parashtruesit nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë (shih, Vanek kundër Republikës Slovake, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendimi i 31 majit 2005) kishin saktësuar se cilat dispozita të Kushtetutës janë shkelur, siç kërcohët me nenin 48 të Ligjit.
22. Nga kjo rrjedh se nuk ka shkelje kushtetuese dhe prandaj kërkesa është qartazi e pabazuar dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 25 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani